



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/3-7385 dt. 16/02 2022

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Milaim Hajdari, më datë: **23.02.2022** (E Merkurë) duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 26.01.2022.
2. Propozim Vendim për vazhdimin e vlefshmërisë së Planit Komunal të Menaxhimit të Mbeturinave për vitin 2022.
3. Propozim Vendim për shfuqizimin e pikës 13, të nenit 1 të Vendimit Nr. 12-360-68569, të dt. 29.11. 2019, të Kuvendit Komunal të Drenasit.
4. Propozim Vendim për formimin e komisionit për çështjet e banimit social.
5. Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit Nr. 12-462/01-4122, të dt. 26.01.2022.
6. Të ndryshme.

Drenas, 16.02.2022



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Zyra e Kuvendit



Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 16. 02.2022, si vijon:

-Pasi kryesuesi përshëndeti të pranishmit njoftoi anëtarët e K. P. F-ca, për rendin e ditës,ku i pyeti të pranishmit nëse ka dikush debat rreth pikave të rendit të ditës mundet me marr fjalën, diskutime nuk pati hedhi në votim rendin e ditës.

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 19.01.2022.
- **Votuan 07 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**
2. Propozim Vendim për vazhdimin e vlefshmërisë së Planit Komunal të Menaxhimit të Mbeturinave për vitin 2022.
- **Votuan 07 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**
3. Propozim Vendim për shfuqizimin e pikës 13.,të nenit 1 të Vendimit Nr. 12-360-68569,të dt. 29.11. 2019, të Kuvendit Komunal të Drenasit.
- **Votuan 07 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**
4. Propozim Vendim për formimin e komisionit për çështjet e banimit social.
- **Votuan 07 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**
5. Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit Nr. 12-462/01-4122, të dt. 26.01.2022.
- **Votuan 07 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**
6. Propozim Vendim për caktimin e lokacioneve për zbatimin e Aktgjykimit C. nr. 97/86,të datës 06.10.1988.
Anëtarët e KPF-së kërkuan që kjo pikë e rendit të ditës me u shty për ndonjë seancë tjetër të radhës.
- **Votuan 01 (Për), Kundër: 6, dhe Abstenim: 00**
7. Të ndryshme. Pati diskutime në interes të qytetareve.

Pasi nuk pati diskutime mbledhja përfundoi në ora 11: 50 min .


Kryesuesi i Kuvendit

Milaim Hajdari



02Nr. 060/64-4388 dt. 16/02 2022

PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **26.01.2022**

Me gjerësisht, mbledhja e tretë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Drenasit.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 29 anëtarë.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Betimi i antarës znj. Blerina Gashi antare e Kuvendit Komunal në Drenas nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës" (PDK), duke e zevëndësuar antarën e Kuvendit Komunal znj. Egzona Jetullahut.
2. Procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Komunal Drenas të dt. 23.12.2021.
3. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizua për vitin 2021 .
4. Plani i vjetor i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022
5. Plani i vjetor i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2022.
6. Propozim Vendim për shfuqizimin e vendimit Nr. 12-400/01-65504,të dt. 23.12.2021.
7. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve:
 - a. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve **Kaltrina Dvorani.**
 - b. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve **Fitore Bytyqi.**
 - c. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve **Besarta Elshani.**
 - ç. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve **Erleta Gjoshi.**
 - d. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve **Medina Hoxha-Hyseni.**
 - dh. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve **Qendresa Bajraktari.**

- e. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve **Mejreme Morina.**
 - ë. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve **Rajmonda Hasi.**
 - f. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve **Hamide Gashi.**
 - g. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve **Mihane Hyseni.**
8. Propozim Vendim për formimin e komisionit për plotsim të ndryshimin e statutit Nr.12.-060/05-14928, të datës 30.04.2020,të Ndermarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” në Drenas.
 9. Propozim Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënjes në Shfrytëzim të pronës së paluajshme të Komunës.
 10. Raporti Financiar i zhvillimit të Buxhetit Janar –Dhjetor 2021.
 11. Lista e rrezeqeve Komunale për vitin 2022.
 12. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Arsim Kulturë Rini dhe Sport. për vitin 2021.
 13. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Ambientit Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2021 .
 14. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Komiteti për Barazi Gjinore për vitin 2021.
 15. Propozim Vendim për lirimin nga pagesa e peronizimit për kompanit e transportit publik të udhëtarëve me autobus për linjat urbano-periferike dhe nderurbane që shfrytëzojnë stacionin e autobusëve në Glllogoc për operim.
 16. Raport nga psikologu Hazir Elshani nga drejtoria e Arsimit lidhur me punën për personat me nevoja të veqanta.
 17. Të ndryshme.



Prezent gjatë mbledhjes së rregullt ishin 29 anëtar të Kuvendit Komunal, Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, drejtor të drejtorive komunale.

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 29 anëtarë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit njoftoi me rendin e ditës ku për diskutim ishin 17 pika për rend dite, ndërsa me propozimin e kryesuesit të Kuvendit të Komunës, pika e 16 ka kaluar në pikën të ndryshme, **Raport nga psikologu Hazir Elshani nga Drejtoria e Arsimit lidhur me punën për personat me nevoja të veqanta.**

Meqë nuk pati diskutime vërejte apo sugjerime kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar dhe votuan me:

12 vota (Për), 10 vota (Kundër), 4 vota (Abstenim).

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- lexoj betimin për anëtarin e Kuvendit Komunal Drenas.

- **Dhënia e betimit nga anëtarja e Kuvendit të Komunës;**

Blerina Gashi anëtare e Kuvendit Komunal betohet: "Betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do ti ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Drenasit (Glllogoc), në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë".

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Komunal Drenas të dt. 23.12.2021.**

Florentina Elezi- të procesverbali kërkoj që me cek gjitha fjalimet, të pika të të ndryshmet ka pas diskutime të rëndësishme dhe nuk janë fare në procesverbal, kërkoj me u cek ato fjalime.

Arber Halilaj- edhe fjalimi im të diskutimi i pikës propozim vendim për lirimin nga qiraja joprofitabile për familjet përfutuese të shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social në Bllokun I dhe II në Drenasin III për vitin 2022, nuk figuron diskutimi im, kërkoj saktësi në këtë çështje.

Labinot Halilaj- në procesverbal kërkohet të shkruhet përmbledhja e diskutimit, nëse ndonjë diskutim është përmbajtjesor lidhur me pikën e rendit të ditës nuk përshkruhet në procesverbal duhet të përfshihet, roli i procesverbalit nuk është transkript me u përfshi gjitha diskutimet që behet këtu me u pasqyru në procesverbal.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi e hodhi në votim Procesverbalin e mbledhjes së Kuvendit Komunal Drenas të dt. 23.12.2021, ka kaluar me ndryshime, prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar dhe votuan me: *29 vota (Për), 00 vota (Kundër), 00 vota (Abstenim).*

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: 3.Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2021

Ariana Isufi- Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Drenasit, me qëllim të transparencës dhe me qëllim të informimit për punën dhe aktivitetet e realizuara, publikon këtë raport për të përmbledhur punën, aktivitetet dhe mbledhjet e mbajtura, gjatë vitit 2021. Si çdo vit, për t'i arritur objektivat e synuara, Komiteti Konsultativ për PAK me fillim vit ka hartuar planin e punës dhe kalendarin për takime për vitin 2021, në bazë të të cilit dhe ka realizuar aktivitetet. Sipas rregullativës së Kuvendit Komunal të Drenasit, Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, ka mbajtur gjashtë (6) mbledhje të rregullta, por jo vetëm. Përveç mbledhjeve të rregullta, ky komitet ka mbajtur afër dhjetë (10) takime të tjera konsultative, përmes të cilave janë konkretizuar ide dhe specifika në aspektin e përmirësimit të jetës së personave me nevoja të veçanta - në komunën e Drenasit. Prioritetet përgjatë vitit 2021

Prioriteteve gjatë vitit 2021, kryesisht i paraprijnë rekomandimet e raportit vjetor të vitit 2020, të cilat janë ngritur për vitin pasues. Ndër të cilat janë:

- ♦ Të vazhdojmë bashkëpunimin me Institucionet Komunale të Drenasit, me qëllim të rritjes së involvimit të personave me nevoja të veçanta në procesin e vendimmarrjes.
- ♦ Bashkëpunimi me OJQ-të që veprojnë në komuna të tjera
- ♦ Bashkëpunimi me OJQ-të që përfaqësojnë persona me nevoja të veçanta, për t'i dëgjuar kërkesat dhe propozimet e tyre për Komunën e Drenasit, në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të caktuara të nivelit komunal të qeverisjes.
- ♦ Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i përvojave me homologë/ anëtarë të Komitetetve Konsultative për PAK nga komunat e tjera, me qëllim të informimit për përvojat pozitive në kuadrin ligjor, në zbatueshmërinë e tij, në organizimin dhe rolin e entiteteve të aftësisë së kufizuar në këto komuna, si dhe me pjesëmarrjen aktive të këtij komuniteti në rrjedhat shoqërore dhe jetën publike.
- ♦ Marrja e pikëpamjeve, kërkesave, propozimeve dhe kritikave të qytetarëve, që kryesisht kanë të bëjnë me investimet në ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës shkollore, rrugëve, trotuarëve, ofrimin e shërbimeve shëndetësore për PAK, gjithëpërfshirja e nxënësve, dhe përcjellja e prioritetëve të tilla tek akterët relevant.
- ♦ Shënimi i datave të veçanta për personat me nevoja të veçanta
- ♦ Realizimi i intervistave dhe/apo hulumtimeve në terren, mbi bazën e identifikimit të aspekteve prioritare që kanë të bëjnë me personat me nevoja të veçanta, dhe ngritja e rekomandimeve praktike mbi bazën e rezultateve.
- ♦ Hartimi i broshurave mbi ndërgjegjësimin e shkollave, institucioneve komunale, dhe shoqërisë në përgjithësi, mbi të drejtat e personave me nevoja të veçanta.

♦ Identifikimi e numrit të nxënësve me nevoja të veçanta të përfshirë në aktivitetet, kurset dhe trajnimet në Akadaminë “Flutura”, në Drenas dhe inkurajimi i kësaj qendre për përfshirje më të madhe të këtyre nxënësve dhe bashkëpunimi me shkollat për t’i evidentuar më lehtë nxënësit e tillë.

♦ Të monitorojmë gatishmërinë e kopshteve për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta, apo zbatimin e praktikës për t’i refuzuar ata gjatë paraqitjes së tyre në procesin e regjistrimit si pjesë e kopshtit. Gjithashtu, objektivi kryesor ka qenë t’i përmbahemi me përpikmëri Planit të Punës, për vitin 2021, dhe nga aktivitetet e realizuara, rezulton se pothuajse të gjitha janë arritur në kohën e planifikuar. Ju rekomandojmë u drejtorive përkatëse si DKRS dhe DSHMS, që të stimulojnë dhe inkurajonë këto organizata, të bëhen pjesë e organizimit të aktiviteteve të tilla, me anë të aplikimit përmes projektpropozimeve të tyre.

Planet Prioritete të Komitetit Konsultativ për PAK për vitin 2022

♦ T’i inkurajojmë personat me nevoja të veçanta, gjithmonë duke shqyrtuar mundësitë për një ambient të përshtatshëm që të zhvillojnë dhe përdorin potencialin e tyre krijues, artistik, dhe intelektual, jo vetëm për të mirën e tyre, por gjithashtu për pasurimin kulturor të shoqërisë.

♦ Komiteti do të angazhohet në monitorimin aktiv të implementimit të legjislacionit për PAK, përmes takimeve mujore me institucionet, si dhe përmes bisedave joformale me zyrtarët e tyre. Pjesë e këtij monitorimi do të jetë edhe zbatimi në praktikë i konkluzioneve dhe rekomandimeve të mbledhjeve të Komitetit.

♦ Shkëmbimi i përvojave me komitetet e komunave të tjera për PAK, për të dhënë ide, për të trajtuar problematikat dhe për të diskutuar për një orientim kundrejt mënyrave me efektive të përmirësimit dhe zgjidhjes sa më të mirë për PAK, si grup target në kuadër të aktiviteteve të Komitetit Konsultativ për PAK.

♦ Hartimi i Materialeve/ Broshurave vetëdijësuese, dhe publikimi i tyre, përveç fushatave ekzistuese, të cilat kanë impakt të zvogëlojnë mundësinë për të diskriminuar qytetarët në bazë të aftësisë së kufizuar.

♦ Komiteti Konsultativ për PAK do të angazhohet që institucionet e arsimit në nivel komunal, të garantojnë një sistem arsimor gjithëpërfshirës para universitar, duke u rekomanduar institucioneve që të marrin masat e duhura për këtë qëllim, duke përfshirë: Lehtësimin e të mësuarit të alfabetit Braille, lehtësimin e të mësuarit të gjuhës së shenjave si dhe trajnimin e stafit që punon në të gjitha nivelet arsimore komunale.

Mehedin Salihu, pyeti: sa është numri i personave me aftësi të kufizuara që është i regjistruar në komunë, cili është stafi që merret me këto dhe çfarë përgatitje profesionale ka, dhe sa psikolog janë të angazhuar?

Ariana Isufi- 1 vjet kemi bashkëpunuar me zyrën e entit për punësim, dhe personat që shkojnë për tu regjistruar në këtë zyre nuk paraqiten si persona me nevojë të veçanta, kjo është një mangësi që neve na pamundëson që me ditë numrin e saktë të personave me nevoja të veçanta

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari, ky është komitet konsultativ dhe e rekomandojnë ato çka është e arsyeshme, nuk është përgjegjës për këto çështje.

Ariana Isufi- jemi 5 anëtar të këtij komiteti që merremi me këto çështje, jemi dy psikologe me titull master, një doktor, një edukatore dhe një profesor, ka qenë një rekomandim i yni që me e rrit numrin e psikologeve në shkollë sepse numri i psikologeve në shkollë është i vogël.

Beqir Kiqina, i falënderoj komitetin për punën që e ka bërë, unë dua ta dije se ky komitet për persona me aftësi të kufizuara çfarë bashkëpunimin kanë me institucione tjera psh me HANDIKOS-in i cili është një institucion mjaft relevant i cili mund t'i shërbejë këtij komiteti dhe komunës tonë që ka një databazë të veçantë për të gjithë personat me aftësi të veçanta me i trajtu, në çfarë niveli ka arritur bashkëpunimin në shkollë, me statistika sa ka bërë komuna e Drenasit dhe ky komitet, sa janë përmirësuar kushtet infrastrukturore, kërkoj që mos me raportu vetëm një herë në vit për këtë komitet por me raportu në qdo 6 muj apo qdo 3 mujë.

Ariana Isufi, ne e kemi udhëzimin Administrativ dhe në bazë të udhëzimit administrativ ne po raportojmë. Bashkëpunimi me HANDIKOS-in ka qenë mjaft i mirë dhe kemi bashkëpunuar me të duke bërë kërkesa dhe se bashku me të kemi arrit me i krye ato kërkesa, edhe bashkëpunimi në shkollë ka qenë shumë i mirë, sidomos me Akademinë "Flutura".

Zeqir Hasi, lidhur me personat me nevoja të veçanta në kuadër të futbollit të Kosovës unë kam arrit që me e fut në projekt edhe Komunën e Drenasit që t'i angazhojmë fëmijët me nevoja të veçanta në aktivitete fizike dhe lojëra elementare të ndryshe, dhe kam kërkuar nga psikologu i komunës Hazir Elshani listën e personave me nevoja të veçanta, mirëpo nuk ma ka siguruar atë listë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, sa i përket listës së fëmijëve me nevoja të veçanta sipas psikologut, mirëpo nëse ju jeni të interesuar që me i dergu fëmijët me nevoja të veçanta atëherë e bëni shpalljen dhe psikologu i njofton kush është i interesuar vjen edhe i bëni ato trajnime.

Zeqir Hasi, nuk po na lejon federata e futbollit pa pas listë, gjitha komunat i kanë ofru listat për këtë projekt e vetëm ne nuk po kemi të drejtë.

Filloreta Bujupi, a është bërë verifikimi i nxënësve me nevoja të veçanta dhe a është bërë transporti i fëmijëve në shkollë ?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, verifikimi është bërë, ndërsa transporti nuk kemi mundur me e siguruar, jemi e vetmja komunë në Kosovë që kemi ndarë mjete për transportin e fëmijëve me nevoja të veçanta, 3-4 herë e kemi bërë shpalljen nuk ka aplikuar askush, mjetet na kanë shkuar suficit, ka kritere të veçanta për me i bartë fëmijët me nevoja të veçanta.

Egzona Tërdevci, pyeti a keni evidencë se sa është zbatuar ligji për persona me aftësi të veçanta sipas të cilave çdo i 50 punëtor duhet të jetë person me nevoja të veçanta, kjo vlen edhe për institucionet publike dhe ndërmarrjet publike që operojnë brenda Komunës Drenasit.

Ariana Isufi, të rekomandimet e ceka që me ju dhënë rekomandim institucioneve komunale që me zbatu ligjin për punësimin e personave me nevoja të veçanta, ku dihet se qdo i 50

punëtor duhet me qenë punëtor me nevoja të veçanta, ne nuk kemi një listë paraprake por vetëm e kemi ngrit si rekomandim.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ne e kemi zbatuar ligjin, në komunën tonë nuk janë çdo i 50 por ndoshta çdo i dhjeti sepse këna shumë zyrtar të cilët kategorinë e invaliditetit e kanë të madh, numri është shumë i madh brenda institucioneve.

Florentina Elezi Veliu, sa janë realizuar këto rekomandime që i ceket nga ekzekutivi.

Ariana Isufi, ka disa projekte që kane mbet ne gjysmë, psh të Drejtoria për Rini Kulturë dhe Sport për Shoqatën e të Shurdhërve kanë ndarë subvencione po thuajse çdo vit, ne ju rekomandojmë që edhe organizatave me apliku për projekte në këto drejtori, dhe kërkoj edhe nga drejtoritë me i stimulu organizata që i përkasin kësaj fushe që me apliku që i përkasin fushës se personave me nevoja të veçanta.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4. Plani i vjetor i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022.**

Arber Halilaj- është pikë e rëndësishme prandaj nuk deshta vetëm me e aprovuar këtë plan plani kur kemi të bëjmë me një plan një vjeçar të Kuvendit Komunal. Kuvendi i Komunës së Drenasit dihet që funksionon në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore dhe Statutit të Komunës së Drenasit. Ky Propozim-Plan Vjetor i punës për vitin 2022, që besoj se është hartuar nga një grup punues i përcaktuar më parë, duhet të shqyrtohet dhe diskutohet sot në mënyrë që ta plotësojmë dhe miratojmë, duke e pasur pastaj si udhërrëfyes të tematikave dhe çështjeve kryesore me të cilat do të merremi gjatë vitit. Sipas LVL-së që rregullon edhe funksionimin e Kuvendit të Komunës (Neni 40, paragrafi 40.2, pika d) definon miratimin e Vendimit për Planin Vjetor të punës si një nga përgjegjësinë e tij që nuk delegohen, siç është cekë në hyrje të këtij plani.

Në Planin Vjetor që e kemi përpara janë cekur edhe numri i mbledhjeve, muaji në të cilin do të mbahen dhe të gjitha punët e aktivitetet e planifikuara, por edhe ato që procedohen në Kuvend nga Kryetari, asamblistët dhe qytetarët, pastaj përgjegjësit si dhe afati i procedimit. Tek çështjet apo tematikat e planifikuara, mendoj se ky plan duhet të plotësohet, meqë është sipërfaqësor dhe nuk përmban shumë tema orientuese, punë e aktivitete të cilat dihen dhe mund të parashihen kur do të jenë aktuale për shqyrtim. Disa nga këto tematika janë:

Muaji janar: Do të duhej të na prezentohet Raporti vjetor i auditimit për pasqyrat financiare të Komunës për vitin 2021, Poashtu, nuk është planifikuar kurrfarë raportimi psh.: nga Drejtoria e Administratës lidhur me vlerësimin e performancës së Komunës së Drenasit, sfidat dhe arritjet v.2021.

Muaji shkurt:

Do të duhej të na prezantohet një informim rreth suksesit të nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2021/2022, sfidat dhe mundësitë në vijim nga Drejtoria Komunale e Arsimit.

Raportim informativ nga klubet dhe shoqatat që janë subvencionuar nga Komuna gjatë vitit paraprak;

Është cekur si datë 17 Shkurti-Dita e Pavarësisë, por nuk shohim ndonjë aktivitet konkret nga Asambleja, të cekur në Planin e Punës, siç është Seanca Soleme e Asamblesë, vënia e kurorave tek shtatorët e heronjve në shesh, vizitë tek familjet e dëshmorëve dhe fshatrat që kanë dhënë shumë për këtë ditë, si Likoshani, Pokleku, Abria etj. Sa më shumë t'i respektojmë këto festa dhe sakrificat për të ardhur deri këtu ku jemi, aq më tepër e forcojmë shtetësinë tonë dhe respektin nga të tjerët për shtetin tonë.

Muaji mars:

Nuk shoh ndonjë pikë diskutimi rreth Planit zhvillimor të Komunës së Drenasit.

Do të mund të planifikohej raportim për punën vjetore ndërmarrjeve publike lokale, Drejtorive të Urbanizimit dhe asaj të Inspeksionit, si dhe planifikimet e aktiviteteve të tyre para fillimit të sezonit të ndërtimeve në pranverë.

Aktivitete të planifikuara nga Asambleja lidhur me shënimin e Epopesë së UCK-së, 5,6 dhe 7 Mars 2022 si dhe një plan të detajuar nga DKRS për këtë ngjarje madhore.

Muaji Prill:

Është shumë mirë që është në planifikim që kur ka përfunduar një tremujor psh.: TM1 të kemi Raportim informues në Asamble nga DFin. i Komunës për periudhën financiare janar - mars 2022 dhe kjo për çdo tremujor;

Informatë për përgatitjet dhe sfidat rreth mbjelljeve pranverore në komunën tonë-çështjet e bujqësisë nuk janë askund tema për shqyrtim në këtë plan pune.

Muaji Maj:

Informim i Asamblesë nga ana e DKRS për aktivitetet rinore, kulturore dhe sportive.

Informim lidhur me ndarjen e bursave për studentët e komunës sonë;

Shqyrtimi i mundësive për të ndihmuar në çfarëdo forme (financa, logjistikë, infrastrukturë, staf etj.) renovimin dhe kthimin në muze të shtëpisë së intelektualit e shkrimtarit të madh të Drenasit e Kosovës, Ymer Elshani.

Raport informativ para Asamblesë lidhur me gjendjen e menaxhimit të mbeturinave.

Raport informativ para Asamblesë nga Ujësjiellësi lidhur me gjendjen e furnizimit me ujë.

Muaji qershor:

Informatë rreth pronave komunale të uzurpuara, regjistrimin e pronave komunale, shkëmbimin e mundshëm me prona private etj.

Informatë nga Policia e Drenasit rreth dhunës në familje dhe në shkolla, dukurive tjera devijante, rendit në komunën tonë etj.

Shënimi i Ditës së Çlirimit me një Seancë solemne dhe aktivitete tjera, që nuk janë cekur në plan;

Muaji korrik:

Është në rregull - Raporti i punës së Kryetarit të Komunës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2022 dhe poashtu plotësisht i qëlluar shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Jashtëm për vitin 2022;

Performanca e Komunës Janar-Qershor 2022 , prezentim nga Drejtoria e Administratës

Informim i Asamblesë rreth performancës së Prokurimit Publik në gjashtëmujor. Informatë nga Njësia e Zjarrefikësve lidhur me gjendjen me zjarret në terren si dhe sfidat tjera të tyre në këtë aspekt.

Muaji Gusht: (pushim)**Muaji shtator:**

Gjendja sa i përket trajtimit të qenve endacak në fillimvitin e ri shkollor;

Prezentim i përgatitjeve të DKA për fillimin e vitit të ri shkollor, sfidat dhe problemet akute;

Propozimvendim për subvencionimin e nxënësve me kushte të vështira ekonomike sa i përket librave e pajisjeve shkollore, udhëtimit, bursave etj. (premtim elektorale i Kryetarit).

Diskutim rreth Propozim-buxhetit final dhe marrja e vendimit për buxhetin 2022-2024 është pikë tejet e rëndësishme dhe e planifikuar në rregull;

Informimi i Asamblesë nga Drejtoria e Bujqësisë lidhur me rendimentet e korrje-shirjeve dhe përgatitjeve për të mbjellat vjeshtore në Komunën tonë;

Informim i Asamblesë nga DKA për rezultatet në mbarimin e vitit shkollor 2021/2022, në testin e arritshmërisë dhe testin e maturës;
Aktivitete të shënimit nga ana e Asamblesë të rënies së heronjve Fehmi dhe Xhevë Lladrovci, vendosja e luleve, vizitë në shkollë.....!

Muaji tetor:

Gjendja ekonomiko-sociale në komunën tonë si dhe mundësitë për zbutjen e saj përmes ndihmesës së familjeve skamnore (premtim elektoral), meqë është periudhë e shpenzimeve të shtuara familjare (shkolla, ngrohja, zahiretë etj.);

Meqë fillon sezoni i ngrohjes dhe ftohja e motit, duhet planifikuar një Informim lidhur me gjendjen e pyjeve dhe mbrojtjen e tyre nga prerja ilegale e pakontrolluar;

Muaji nëntor:

Gjendja e infrastrukturës rrugore dhe mirëmbajtja e saj, përgatitjet për sezonin dimëror;

Raport informues i Drejtorisë për Shëndetësi lidhur me gjendjen në institucionet shëndetësore, sfidat dhe mangësitë;

Seancë solemne e Asamblesë për shënimin e festës së 28 Nëntorit.

Muaji dhjetor:

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Kuvendit të Komunës dhe të Kryetarit për vitin 2022.

- Informatë rreth përgatitjeve për Festat e fundvitit nga Komuna;
- Nuk është planifikuar kurrfarë raportimi apo informate rreth punës vjetore dhe aktiviteteve të Komiteteve të Asamblesë për vitin 2022.

Vetë termi Planifikim apo Plan i Punës tregon për një aktivitet të rëndësishëm intelektual në çdo veprimtari. Puna jonë mund të jetë e suksesshme vetëm nëse ka planifikim të mirë, të detajuar dhe të matshëm në kohë dhe resurse, teorikisht të paraqitur në një plan. Mendoj se Plani Vjetor i Punës së Asamblesë së Drenasit i prezantuar para nesh mund të jetë edhe më specifik, më përmbajtësor dhe reflektim i kohës dhe nevojave të qytetarëve të komunës sonë. Kjo mund të arrihet nëse merr parasysh dhe plotësohet me propozimet tona që i japim këtu gjatë shqyrtimit, meqë ky nuk është plan i punës vetëm për Kryesuesin, por për secilin nga ne që jemi pjesë e Asamblesë. Si i tillë, duhet të plotësohet me objektivat dhe synimet që i theksova, e po ashtu të jetë sa më i harmonizuar me planet e punës së Drejtorive dhe Kryetarit

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, plani që e keni para jush është e datat apo koha e mbledhjeve s ai përket raportimeve se drejtorive janë të gatshme me ju raportuat te te ndryshmet për çfarë do interesimi që keni, sa i përket raportit të auditorit deri ka muaji shtator e kemi për obligim me e sjellë, nuk do të na ik asnjë gjë, unë jam për bashkëpunim ne të mirë të qytetareve çdo here.

Labinot Halilaj, plani punës është obligim ligjor, temat që i ngrite janë tema të rëndësishme, mirëpo sa i përket planit mendoj se është paraqitur shume mirë edhe datat edhe temat dhe planifikimi i mbledhjeve, i përgëzoj për punën.

Hamit Haxhiu, në plan janë të ngarkuara vetëm 4 data të rëndësishme, pse mos të ketë më shumë tema të ngarkuara psh. 17 shkurti pse mos të jetë edhe 28 shkurti masakra e Likoshanit me pas e kemi masakrën e Poklekut, masakra e Abrisë etj të kemi ndonjë aktivitet.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ne gjitha këto data i mbajmë aktivitetet çdo herë i organizojmë dhe kam dëshirë me qenë bashke sepse është mire me tregu një unitet.

Beqir Kiqina, edhe me herët e kam cek që me u marrë parasysh shënimin e datës së Epopesë se Llapushnikut, kërkoj nga kryetari se këtë vit a ka mundësi të shënohet kjo datë dhe të

përkujtohet ose nën patronatin e kryetarit, apo komuna të bëj kërkesë edhe zyrës të kryeministrit të Kosovës.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ne qoftë se qeveria e mban këtë datë ne organizohemi, edhe unë jam për me i kujtu këto gjera me vepra dhe pune të mira.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi e hodhi në votim Planin e punës se Kuvendit Komunal për vitin 2022, prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar dhe votuan me: *23 vota (Për), 1 votë (Kundër), 3 vota (Abstenim).*

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Plani i vjetor i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2022.**

Egzona Tërdevci- lidhur me planin e punës së kryetarit për vitin 2022 kërkoj disa sqarime në disa fusha të ndryshme, sa i përket arsimit e kam shikuar që në plan të jetë hartimi i planit individual të arsimit të nxënësve me nevoja të veçanta sipas planifikimit është menduar që të bëhet në fazën janar – mars 2022 meqë jemi në fund të janarit a keni filluar punën me këtë plan? Po ashtu pyeti: studentet që kanë përfituar bursat e që janë në listën e pritjes mirëpo mjetet nuk i kanë marrë akoma, a janë siguruar mjete për këta student? Po ashtu ne mandatin e juaj e keni bërë zotimin për 4 çerdhe publike a do të realizohet brenda këtij viti ky premtim. Sa i përket Rinisë, Kulturës dhe Sportit pyeti për Pishinën gjysmë Olimpikë në Komoran a do të përfundoj ky projekt brenda këtij viti? Hulumtimi dhe restaurimi i kalasë së Vuqakut në fshatin Vuçak cili është roli i komunës në këtë projekt kur ky projekt është i nivelit qendror, përkatësisht i Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit ku janë ndarë 100 mijë euro për këtë projekt. Nga fusha e bujqësisë e keni përmend përkrahjen direke me pajisje, dhe mjete bujqësorë pagesën e ujitjes nga Iberlepenci në cilin vit do të behet kjo? Po ashtu në drejtorinë e urbanizimit a do të përfundoj ndriçimi publik brenda Drenasit për vitin 2022 përfshirë edhe fshatrat, si dhe sa do të jetë mbuloshmëria e ndërtimit të kapacitetit të ujësjellësit në Drenas.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, për studentet ia kemi paguar gjithë atyre që e kanë fituar bursën brenda buxhetit të komunës i kemi përfunduar ndërsa ne deri në vitin 2021 gjithë studentet që i kanë përmbush kriteret i kemi siguruar bursë nga donatorët, ne do të provojmë të sigurojmë donatore që t'i plotësojmë të gjithë studentet sipas kriterëve që e kanë fituar bursën, deri me tani 35-40 bursa i kemi siguruar nga donatorët, ndërsa të tjerët do të bëjmë përpjekje që t'i sigurojmë donatorët. Sa i përket çerdheve asnjëherë nuk kam premtuar që do t'i ndërtojmë 4 çerdhe. Pishina e ka pas buxhetin e ndarë nga qeveria e kaluar, është projekt nga qeveria ndërsa ne jemi ata që e kemi nxjerr buxhetin, ne jemi ata që është që është miratuar nga kuvendi paraprak blerja e pronës për qellim ndërtimin e pishinës dhe stadionit sintetik dhe komplekseve tjera që ne të ardhmen do të ndërtohen në atë pronë prej afër 9 hektarësh. Pishina do të ndërtohet mirëpo nuk kam thënë që do të përfundoj brenda vitit 2022. Kalaja e3 Vuqakut be jemi duke e shtruar rrugën për të kalaja veç kemi filluar është investim i komunës, gjysmën e kemi përfunduar na ka mbet edhe një pjese mirëpo do ta përfundojmë shumë shpejt. Sa i përket Iberlepencit ne kemi bërë marrëveshje me të me i subvencionuar 20 mijë euro bujqit. Sa i përket ndriçimit për komunën tonë çdo shtyllë e betonit qofte rruge publike dhe ne fshatra tona do ta këtë brenda viti 2022, çdo lagje deri në fund të vitit 2022 do të ndriçohet.

Egzona Tërdevci- sa do të jetë mbuloshmeria e ndërtimit të kapacitetit të ujësjellësit në Drenas duke pas parasysh që 22 vendbanime nuk kanë ujë , sa prej tyre do të përfshihen?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, për projektin e ujësjellësit 2022 përfundon me kushtin që nga bazeni i Kamenicës siç e quajmë ne qoftë se ka rrjet të ujësjellësit , nuk ka rrjet nuk kam të drejtë me zhvillu procedura, psh mungon rrjeti, sipas raporteve rrjeti ehtë i paguar i vendosur dhe nuk është realisht atë nuk kemi të drejtë me e përfundu sepse duhet me i kry procedurat tjera. Ne e kemi miratuar në këtë kuvend ndërtimit e liqenit ujë grumbullues në Verbovc për 40 mijë banorë të Drenasit, mjetet kanë qenë të ndara do të bëhet ose me kredi hungareze ose me mjete të taksapaguesve të Kosovës, e kemi dërguar edhe vlerësimin e pronave të qytetareve të cilat kanë me u shpronësu, qeveria në qofte se na heq projektet unë nuk kam qfarë të bëjë. Mirëpo për ujë nuk është i mjaftueshëm ai rrjet sepse ka shumë pak, ne rrjetin do ta përfundojmë mirëpo ai ujë nuk mjafton por për me pas ujë 24 orë duhet edhe ju me ndiku të qeveria që me e ndertu liqenin ma shpejt.

Egzona Tërdevci, ne qofte që bahet ujësjellësi deri në fund të 2022 nuk ka me pas ndonjë njeri ma të lumtur në Drenas se sa na edhe kemi me ardhe me ju duartrokit.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci - ne e kemi në këtë kuvend këtu e kemi miratua edhe ndërtimin e liqenit ujëgrumbullues në Verbovc për 40 mijë banor të Drenasit kanë qenë mjetet e ndara, uji nuk është i mjaftueshëm, unë rrjetin e kryej unë ujt e lëshoj po duhet me pas 24 ore ujë e për me pas 24 ore ujë duhet edhe ne me ndiku të nivelit qendror, me ba liqenin ma shpejt liqeni nuk bohet për 2-3 vjet.

Egzona Tërdevci, realisht na prej pozicionit që jena nuk jem ktu mi mbrojte as mi perfaqsu interesat e nivelit qendror unë mundem veq me ju garantu prej asaj çka kom pa prej prezantimeve publike të qeveris edhe të gupeve parlamentare të LVV që furnizimi me ujë të pijes për të gjithë është zotim edhe i tyre në këtë pike keni me pas përkrahjen tone edhe pse jeni i subjektit tjetër.

Arber Halilaj- Meqë është mandati i dytë si Kryetar Komune, Plani Vjetor i punës së Kryetarit do të doja të fillojë me një analizë të përparësive, mundësive dhe sfidave që ai i sheh në menaxhimin e komunës me të gjitha kompetencat ekzekutive që ka dhe bazuar në këtë analizë të bërë nga Zyret dhe Drejtoritë të orientojë edhe prioritetet në qeverisje, të përcaktojë vizionin dhe synimet në këtë mandat. -Tek parimet apo tri shtyllat kryesore të qeverisjes, e potencon që “unë si Kryetar i Drenasit siguroj që barazia para ligjit....”, ndërsa barazia para ligjit sigurohet jo nga Kryetarët e Komunave dhe jo si parim i qeverisjes lokale, sepse gjyqësori do të duhej të jetë i pavarur në një shtet ligjor. Barazinë para ligjit , si një e drejtë e individit dhe si vlerë demokratike, na e sigurojnë dhe garantojnë aktet e brendshme juridike të shtetit tonë si dhe institucionet gjyqësore. Një aspekt tjetër sa i përket ligjit do të mund ta siguronte Kryetari dhe ta potenconte në Plan të Punës: do t’i nënshtrohem sundimit të ligjit bashkë me vartësit, duke iu kërkuar atyre përgjegjësi për veprime joligjore, për keqmenaxhim buxheti, për keqpërdorim pozite dhe veprime tjera që bien ndesh me ligjin. Janë theksuar tri nga prioritetet kryesore të qeverisjes: rritja e cilësisë në arsim, në shëndetësi dhe zhvillimi ekonomik, bazuar sigurisht edhe në premtimet elektorale të dhëna. Por, në Planin Vjetor të DKA që do të duhej të detajizonte këtë prioritet apo objektivë, nuk shohim veprime apo plane konkrete në këtë drejtim, përveç fraza të përgjithësuar si “ngritja e kapaciteteve në procesin mësimor”, “

Objektivat, strategjitë dhe aktivitetet për avancimin e procesit arsimor”.... Me cilat veprime, në cilën periudhë, cilët janë përgjegjësit, sa është buxheti për këtë synim ? Një nga hapat në këtë drejtim, që nuk është cekur askund, është planifikimi i ndërlidhjes së sistemit arsimor me tregun e punës dhe bizneset e Drenasit, për realizimin e praktikës mësimore – pra, *ndërlidhja e teorisë me praktikën* e rritë cilësinë sepse ndikon në punën kreative dhe motivimin e nxënësve, si dhe lehtëson zgjedhjen e profesionit jetësor më vonë. Është për tu përshëndetur objektiva e organizimit të shërbimit pedagogjike-psikologjik nëpër shkolla, mirëpo mungon objektivi tjetër po aq i rëndësishëm sa i përket shëndetit, pra planifikimi i kontroleve dhe vizitave mjekësore e stomatologjike nëpër shkolla. Këtij dhe planeve të disa Drejtorive iu mungon operacionalizimi, duke mos e cekur synimin e një objektive, përgjegjësit, afatet kohore të realizimit etj. që çdo plan i punës duhet t’i ketë. Zyra juridike (Avokati i Komunes) mendoj se do të duhej ta ketë prioritet kryesor ofrimin e këshillave juridike të rregullta për Kryetarin, Kuvendin Komunal, Drejtoritë, komisionet, Prokurimin Publik dhe trupat tjera komunale, objektiv ky i cili nuk figuron në plan. Zyra e Auditorit të Brendshëm mund të them që ka përpiluar një Plan Pune shembull dhe me të gjitha elementet e kërkuara. Vet qasja e tyre këshilluese dhe nxitëse, kur kemi parasysh që është aktivitet i pavarur, si dhe tipet e aplikuarat të auditimit janë garanci se kjo Zyre është në funksion të sigurisë dhe kontrollit se objektivat strategjike të Komunës janë duke u përmbushur në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Poashtu, është bërë sqarimi teorik dhe operacionalizimi tabelar i rrezikut, objektivi i detyrave të planifikuara, prioriteti, njësia që auditohet si dhe detyra e auditimit, që janë ndërlidhur edhe me Planin Strategjik 2022-2024. Unë vetëm e përgëzoj Zyren e Auditimit për profesionalizmin dhe planifikimin e qartë. Zyra për Komunikim me Publikun ka një Plan të Punës “copy-paste” nga vitet e kaluara, kështu që nuk do ta analizoja më tepër. Zyra e Burimeve Njerëzore përveç punëve administrative e teknike sa i përket personelit, do të duhej më shumë të koncentrohej në aplikimin e meritokracisë dhe kriterëve për avansim në karrierë, si dhe në çështjen shumë të rëndësishme të planifikimit të trajnimeve specifike, që ndikojnë në avansimin profesional të stafit nëpër drejtoritë dhe shërbimet përkatëse. Poashtu, është shumë me rëndësi vlerësimi i performancës në bazë të objektivave dhe arritshmërisë së tyre, që duhet të zëj vend në planin e punës. Drejtoria e Administratës – mund të konsiderohet si storie suksesi në Komunën tonë, mirëpo nivelin e mirë të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe funksionalizimin e mëtejshëm të tyre mund ta mbajë dhe ngris vetëm përmes ngritjes së shkallës së bashkëpunimit me ministritë përkatëse MAPL, MPB, MAP, ministritë dhe institucionet, organizatat qeveritare dhe joqeveritare etj., gjë që ky objektiv nuk figuron në Planin Vjetor të Punës, ndërsa është i domosdoshëm si bashkëpunim.

Kryetari i Komunës - Ramiz Lladrovci- Faleminderit po i marr për sugjerime krejt këto qa i ke thënë ky është një plan i punës në vija të trasha i propozuam edhe nga drejtorit përkatës dhe institucionet tjera zyra e auditorit funksionon në kuadër të zyrës së kryetarit edhe kjo është e arritur e kryetarit, barazia para ligjit është sepse unë jam i obliguar qytetarit mi dhanë përgjigje në afate me i kry projektet investimet, pra ky zotim i joni edhe osht si obligim ligjor.

Albulena saliuku –kërkoje që të jemi unik të gjithë në të gjitha datat e të gjithë dëshmoreve pa bërë ndarje të opjeve siç e dimë secili fshat i Drenasit ka dëshmorë të luftës dhe duhet të nderojmë në mënyrë të organizuar ose përndryshe këto mujm me ba dhe në mënyrë individuale sepse mbi të gjitha e kemi obligim.

Hamit Haxhiu- ne planin e tij e nuk janë e përmend edhe masakrën e Pokleikut qe flitet për te 14 qe është data e denocidit nuk eshte data e Masakres se Pokleikut, nuk muj tha me mirëmbajte muzeun Ymer Elshani duhet te behet qmos per muzeun ku dihet qe Ymer Elshani rasti tina me familje eshte rast unikat ne botë ktu duhet te behet zgjidhje per kto pika.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari, 15 janari është dita e denocidit shënohet me maskren e Reqakut një shoqat kësaj rraddhe ka organizu na komuna nuk kemi pas ftese ne te njëjtën kohe edhe unme jom ndi keq pse skom mujte mju dergu edhe une ftese se zakonishte kryetari gjithemone përfshinë asamblenë kur ta dite te shenume te rëndësishme do te thotë kjo nuk na ike,ndërsa per at tjera mënoj qe kryetari ke mjafti i qarte edhe u sqaru gjate ne raporte me Arberin po edhe diqka nje keshille te sinqerte pjau dha do te thotë na jem kete vite na implementojme buxhetine miratum te vitit te kaluar do te thotë buxheti miratohet nje vite paraprakishte ne vitin qe jemi aktual kjo asamble ka me qene ajo asamble qe ka me miratu buxhetin per vitin 2023 dhe pikerishte jeni ktu per te dikutu dhe per te inacu çdo kerkese qe ju interesone.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Propozim Vendim për shfuqizimin e vendimit Nr. 12-400/01-65504,të dt. 23.12.2021.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim Propozim Vendim për shfuqizimin e vendimit Nr. 12-400/01-65504,të dt. 23.12.2021, prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar dhe votuan me: *26 vota (Për), 00 vota (Kundër), 0 vota (Abstenim).* Me 26 vota *Për* shfuqizohet vendimi Nr. 12-400/01-65504, të dt. 23.12.2021.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve.**

Drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik, Egzona Jetullahi- sa i përket kësaj pike të rendit të ditës bazohet ne vështirimin e nenit 58 paragrafi 1, nen paragrafi h, të ligjit për vetëqeverisje lokale nr 03/L-40, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 nr. 320-19338 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes se subvencioneve, rregullores MF-NR04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat financimit publik të OJQ-ve, vendimi nr 12 nr 400-37743 të datës 03.07.2018 për plotësim ndryshimin e rregullores nr. 12-320-19338, për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes se subvencioneve, thirrja publike e cila nr.05-070-41076 te dt. 24.08.2021. Rekomandimi Nr. 01-020/04-65728 të dt. 24.12.2021, pastaj buxheti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2021, me propozim të drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, ne si drejtori kemi të drejte te bëjmë ndarjen e subvencioneve, ka qenë aplikacioni i hapur për të gjithë të interesuarit e Komunës së Drenasit që te aplikojnë këtu dhe përfituesit janë zgjedhur. Unë këtë për kuvend e kam sjellë si një pikë të vetme ndërsa në kuadër të saj kanë qenë përfituesit duke u bazuar në rregulloren paraprake dhe neni t që i lejohet kryetarit të komunës dhënia subvencioneve deri në vlerën 1500 €, komisioni ka vendosur që përfituesit në bazë të planit te biznesit të kenë shumën më të madhe se 1500 € dhe kjo si pikë e rendit të ditës duhet të kalohet në kuvend në bazë të atij vendimi pastaj kryetari ka te drejtën e nënshkrimit te ndarjes se këtyre subvencioneve. Të gjithë materialin e keni te gatshëm si ka shku procedura.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve:

a. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve

Kaltrina Dvorani.

b. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve

Fitore Bytyqi.

c. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve

Besarta Elshani.

ç. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve

Erleta Gjoshi.

d. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve

Medina Hoxha-Hyseni.

dh. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve

Qendresa Bajraktari.

e. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve

Mejreme Morina.

ë. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve

Rajmonda Hasi.

f. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve

Hamide Gashi.

g. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve

Mihane Hyseni.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar dhe votuan me: *28 vota (Për), 00 vota (Kundër), 1 vota (Abstenim).*

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **Propozim Vendim për formimin e komisionit për plotësim të ndryshimin e statutit Nr.12.-060/05-14928, të datës 30.04.2020,të Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” në Drenas.**

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci- nga ekzekutivi e propozojmë: Valmir Bajraktari ju keni me i propozu edhe dy anëtar tjerë.

Bekim Lestrani-grupi kuvendar i PDK-së propozon: Gani Krasniqin.

Azemine Gjoka-grupi parlamentar nga DD propozon për anëtar të komisionit: Mehedin Salihu.

Pas propozimit për formimin e komisionit për plotësim të ndryshimin e statutit Nr.12.-060/05-14928, të datës 30.04.2020,të Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” në Drenas, me përbërje te komisionit: Valmir Bajraktari- nga ekzekutivi

Gani Krasniqin- anëtar nga Kuvendi Komunal.

Mehedin Salihu- anëtar nga Kuvendi Komunal

Kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar dhe votuan me: *29 vota (Për), 00 vota (Kundër), 0 vota (Abstenim).*

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës: **9. Propozim Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në Shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.**

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci- edhe për këtë e kemi për obligim që me formu komision, nga ekzekutivi e propozojmë: Flutura Avdiu

Enver Hoxha

Arben Kuliqi - nga shoqëria civile.

Bekim Lestrani-grupi kuvendar i PDK-së propozon: Qendrim Mulaj.

Azemine Gjoka-grupi parlamentar nga DD propozon për anëtar të komisionit: Filloreta Bujupin.

Zeqir Hasi, kërkoj me pas një raport për pronat si legjislaturë e re me shiku deri ku kanë shku procedurat, me pas një raport me shiku se a janë përmbush kriteret kush i ka përfitua pronat, se ligji nr. 06/L-092 neni 22 thotë Komuna mbikëqyrë realizmin e kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme

të komunës sipas planit dinamik realizues.2. Kryetari i Komunës obligohet që në raportet e tij të rregullta gjashtë (6) mujore ti paraqet

Kuvendit të Komunës edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe

përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, deri në fillimin e implementimit dhe arritjes së qëllimit të dhënies së pronës në shfrytëzim.

3. Në rast të mos realizimit të planit dinamik të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së

paluajtshme të komunës, duke tejkaluar afatet e përcaktuara me kontratë, Kryetari i Komunës merr vendim për shkëputjen e kontratës. Më këtë vendim njoftohet Kuvendi i Komunës.

4. Në rast të evidentimit të shkeljes së kontratës apo shmangies nga qëllimi i shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës nga shfrytëzuesi, kryetari i komunës obligohet që në çdo kohë të njoftoj Kuvendin e Komunës me shkrim, së bashku me rekomandimin e tij për shkëputje të kontratës apo masat e caktuara ndaj shfrytëzuesit. Unë po kërkoj që në këtë komision mos të jene anetar4et që kane qenë në komisionin e kaluar, nga OJQ-të është mirë që me mbajt mbledhjen at qa dhe me pas një proces te mbledhjes dhe të vjen propozimi nga Organizata joqeveritare sepse si pasoj e komisionit të kaluar ne kemi tash shumë prona që janë në kontekst gjyqesor, propozoj që të formohet një komision monitorues dhe me i përcjell gjitha to prona që janë dhënë a i kane zbatuar gjitha ato kriteret që i kanë marrë, ka prona që ju ka skaduar afati i kantatës dhe ende po shfrytëzohen.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci- pika e rendit të ditës është për formimin e komisionit, nuk është kjo teme brenda rendit të ditës, të ndryshme mundeni me diskutua çdo interesim te juajin. Deri më tani asnjë pronë nuk është nen hetim, çdo pronë që e kemi dhënë në shfrytëzim ka qenë në emër të komunës dhe çdo prone që ka qene ne emër te komunës aplikon dhe e fiton ai që i plotëson kushtet dhe kriteret për atë pronë, vetëm gjema një pronë e ma sjellë që është në kontekst .

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, me përbërje të këtij komisioni:

Flutura Avdiu - nga Ekzekutivi

Enver Hoxha - nga Ekzekutivi

Arben Kuliqi - nga shoqëria civile.

Qendrim Mulaj - anëtar nga Kuvendi

Filloreta Bujupin - anëtar nga Kuvendi

Prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar dhe votuan me: **26 vota (Për), 00 vota (Kundër), 2 vota (Abstenim).**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës: **10. Raporti Financiar i zhvillimit të Buxhetit Janar –Dhjetor 2021.**

Drejtori i Financave, Shyqeri Bublaku- Sqaroj në pika të shkurtra arsyetimin e këtij propozim vendimi.

Florentina Elezi, tek përqindja e realizimit të investimeve kapitale të shëndetësia primare është vetëm 31 % e realizuar, gjithashtu administrata dhe personeli 53 %, dhe për Kulturë Rini dhe sport 57 % kërkoj sqarime.

Drejtori i Financave, Shyqeri Bublaku- OSHP-ja vitin e kaluar ka qenë jo funksionale dhe shumë projekte na kanë mbet pa u zhvilluar për arsye të OSHP-së, një ankesë e një operatori ekonomik e shkuar në OSHP derisa ai ska qenë funksional ka mbet pa u zgjidh edhe projekti pa u zhvilluar, të njëjti nproblem e kemi pas edhe me drejtori tjera ska qenë vetëm për një drejtori ap onjë sektor por për të gjithë sektorët.

Egzona Tërdevci, sa është shuma që ka paguar Komuna e Drenasit për raste të përmbarimit he procedurave gjyqesore për vitin 2021?

Drejtori i Financave, Shyqeri Bublaku, 499 mijë euro janë paguar për paga jubilarë ushqim të punetoreve të sektorit arsimit dhe të shëndetësisë dhe te udhëtimit.
Nuk pati me diskutime tjera dhe kaloj tek pika tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës: **11. Lista e rreziqeve Komunale për vitin 2022.** Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kaloj tek pika tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës: **12 Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Arsim Kulturë Rini dhe Sport për vitin 2021.**

Gentrit Muaku- Gjatë vitit 2021, ne, Komiteti Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport kemi mbajtur gjashtë mbledhje. Në këtë takim kemi diskutuar për fushëveprimtarisë që mbulon komiteti ynë, kemi hartuar planin e veprimit për vitin 2021 si dhe kemi ndarë detyrat dhe përgjegjësitë për secilin anëtarë të komitetit. Pati sqarime rreth këtij komiteti dhe Në fund, shpresojmë se rekomandimet tona do të trajtohen seriozisht dhe do të merren si të mirëqena dhe dobiprurëse për arsimin, kulturën, rininë dhe sportin në Drenas.

Egzona Tërdevci, e shikova që në raport keni dhënë rekomandime për DKA-në dhe DKRS-në, a keni diskutuar me drejtorinë a do të përfillen rekomandimet e juaja?

Gentrit Mulaku, vitin 2020 kemi pas rekomandime dhe janë realizuar disa prej tyre, ndërsa shkaku pandemisë si psh disa festivale e disa aktivitete të tjera nuk kanë mundur të realizohen.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës: **13. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Ambientit Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2021.**

Fitore Sefiu- Aktualisht është viti i tretë që Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Mjedisit Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale vepron në kuadër të Komunës së Drenasit.

Është viti i dytë i pandemisë, në të cilin vështirësitë po na përcjellin në kohë të vazhdueshme duke reflektuar edhe në komitetin tonë.

Kemi pasur gjashtë takime formale dhe takime joformale. Për punën tonë është njoftuar edhe opinion publik për mes faqes që kemi hapur në njërin nga rrjetet sociale nga e cila kemi shqyrtuar edhe disa probleme që qytetarët na kanë njoftuar përmes saj.

Duke besuar se pas çdo vështirësie do vijë edhe lehtësimi duhet edhe më shume të inkurajojmë projekte që për qëllim kanë përmirësimin e mirëqenies sociale për banorët tanë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katërmëdhjetë të rendit të ditës: **14. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Komiteti për Barazi Gjinore për vitin 2021.**

Arton Hasani- në pika të shkurtra foli për aktivitete që i kane mbajtur gjatë vitin 2021 dhe dha disa rekomandime.

Florentina Elezi, tematika ishte jashtë tematikave dhe përgjegjësi që ju takojnë, për një strehë që e ceket me lartë për raste emergjente për viktimat e dhunës, a keni marr ndonjë hap dhe sa është e mundur me u realizua ky projekt në komunë tonë? E përmendet që do ta bëni një fushat vedijesuse për dhunën ne familje me nxënësit a është realizuar kjo fushatë?

Arton Hasani, ne vetëm i kemi dhenë si rekomandime dhe tjetër kush i zbaton ato.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci- nuk kemi te drejtë me bë shtëpi rehabilituese se nuk kemi buxhet për staf, edhe me pas donator me ndërtua atë shtëpi mirëpo nuk kemi staf, një shtëpi për rehabilitim ditor është.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katërmëdhjetë të rendit të ditës: **15. Propozim Vendim për lirimin nga pagesa e peronizimit për kompanit e transportit publik të udhëtarëve me autobus për linjat urbano-periferike dhe nderurbane që shfrytëzojnë stacionin e autobusëve në Glllogoc për operim.**

Beqir Kiqina, duam ta dimë lirimin nga pagesa për kompanitë e transportit?

Drejtoresha e shërbimeve publike dhe emergjente, në bazë të ligjit për vetëqeverisje lokale në bazë të statutit të komunës së Drenasit, ligjit për parandalim të covid 19, rregullores për taksa, tarifa dhe gjoba, dhe në bazë të kërkesës të adresuar nga transporti i udhëtareve me autobus në Drenas, vështirësitë që janë për kompanitë e transportit të udhëtareve në Drenas kemi kërkuar që të behet lirimi nga peronizimi nga kompanitë e transportit publik të udhëtareve për linjat urbane periferike dhe nder urbane që shfrytëzojnë stacionin e autobusëve në Drenas për operim, lirimin nga pagesa e peronizimit është me afat kohor prej 6 muaj me mundësi vazhdimi varësisht prej gjendjes pandemie.

Kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 27 anëtar dhe votuan me: *26 vota (Për), 00 vota (Kundër), 1 vota (Abstenim)*.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pesëmbëdhjete të rendit të ditës: 15. Të ndryshme.

Hamit Haxhiu, ne psikologun e kemi thirr sot për interpelance, dhe ne kemi kërkuar që me raportu, aty ishte vetëm si informatë.

Florentina Elezi-Veliu, unë e kam ftuar psikologun e komunës me raportu sepse kam pasur dy raste që më kanë shqetësuar dy raste konkrete mirëpo e di që ka shumë në komunën tonë, e para është ne kopshtin "Ardhmëria" në Drenas është një klasë me parashkollor ku janë 6 fëmijë me nevoja të veçanta dhe gjithsej 22 fëmijë është numër i madh i nxënësve dhe është e pamundur me realizu orën plus me 6 fëmijë me nevojë atë veçanta, unë kam kërkuar që me bashkëpunu, unë kam kërkuar që bashkërisht me gjet një zgjidhje që me rrit numrin e asistenteve, u në e di që është vetëm një asistente, kisha propozuar sikur ne Prishtine psh. studentet shkojnë në mënyrë vullnetare me e bërë materialin, praktika i duhet secilit student dhe në këtë rast kopshtit i duhet ndihma dhe është nevojë reciproke. Shqetësimi i dytë është që një nxënës në fshatin Abri i shkollës fillore kur janë mbyllë shkollat ai është me nevoja te veçanta dhe ka ndikuar sipas psikologut ka ndikuar dhe ai fëmijë nuk ka mundur me shku në një shkollë tjetër, transport për fëmijë me nevoja të veçanta nuk ka pas, ai fëmijë ka mbet pa shkuar në shkollë dhe psikologu që nuk është i informuar për këto çështje.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci- nuk lejohet në një klasë në çerdhe numri me i madh se sa që lejohet për një punonjës edukatore, sa i përket praktikanteve të fakultetit pa leje të universitetit përkatës çdo me e dërgu psh një student me një klasë që ka fëmijë me nevoja te veçanta nuk ka të drejtë dhe ne nuk kemi të drejtë me pranë, sa i përket atij djalit në fshatin në Abri, unë e kam mbyllë paralelen kundërligjshëm, unë e kam zbatuar ligjin. Sa i përket bartjes së nxënësve obligim ligjor e kam me transportu çdo nxënës që e ka rrugën prej shtëpisë në shkollë 4 km në një drejtim ose 8 km në dy drejtimet. Ju e keni thirr psikologun me raportu aq sa ja lejon ligji për me raportu për ndryshe mundeni me bërë kërkesë në qasje të dokumenteve dhe merrni përgjigje.

Hazir Elshani, komuna e Drenasit është njëra ndër komunat me të mira që ju ka ndihmuar kësaj kategorie. Vlerësimi i fëmijëve me nevoja te veçanta behet me kërkesë të prindërve, dhe institucionit, dhe ne detyrohemi me afat ligjor që me iu kthi përgjigje për këtë çështje. Në pika të trasha i sqaroj gjitha ato procedura që behen për fëmijë me nevoja të veçanta. Edhe në shkollë ne shkojmë kur na bëjnë ftesa gjithherë.

Florentina Elezi-Veliu, nuk jam duke e përdorur këtë për diçka të keqe por bashkërisht me bërë diçka të mirë, unë kam qenë në mbledhje të prindërve në kopsht dhe drejtoresha ka thënë që të ka lajmëruar, rekomandimi ka qenë i gjithë prindërve që me bërë kërkesën që nga muaji tetor dhe ti ende nuk ke qenë me vizitua kopshtin, dhe unë nuk jam duk e përmendur asnjë emër jam duke e përmend si fenomen.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci- institucionet publike i kanë krijuar kushtet për njerëz me nevoja të veçanta.

Egzona Tërdevci, kemi pranuar shqetësim lidhur me konkursin e dt . 16.12.2021 nga te cilët dhe disa të punësuar janë edhe mbështete ste këtij pushteti njëra është gruaja e drejtorit ndërsa tjera ne radhët e asamblesë te PDK-së madje për zonjën ne fjalë nga informatat që i kemi pranuar informatë se zonja ka pranuar punën qysh para dy muajve, ne kemi një propozim qe kur janë intervistat me goj për mësimdhënës te jemi edhe ne prezent si anëtar te asamblesë komunale ne rolin e vëzhguesit nëse e njëjta nuk përjashtohet nga ligji.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, komisionet profesionale ne Komunën e Drenasit e kane për obligim me i fut ne testim me shkrim edhe me goj kandidatet, kandidatet ma të mire zgjidhen, çdo kandidat nëse nuk është i kënaqur me vlerësimin e ka afatin e ankesës dhe është komisionit që e shqyrton ankesën.

Egzona Tërdevci- jane tri qashtje te shkurta e para kur kom kerku qasje ne dokumenta publike une kom kerku ni pa testet une veq kom dashtë mi pa pikt prej testimit pikt prej intervistet edhe pikt prej biografis,une dhashë nje supozim prej nje informate qe kemi marr prej dikujt qe zonje Muhadri-Mulaku ka fillu punën paraprakishte para se me qene konkursi rreth dy muaj me herëta mundemi me nau përgjigj nëse qëndron apo jo kjo edhe bona edhe e bona nje propozim qe ne me kenë ne rolin e vëzhguesit normal pa te drejte te fjalës edhe pa te drjte ndërhyrje kur mbahen intervistat per mesimmedhenes me goje a kemi te drejte ne kete pjese,faleminderit

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci,, une nuk i ika as nje përgjigje po e harrova nuk e di a ja ka nis dy muje përpara dy muje mrapa, ligji per arsimin e ka nje rregullore te vete kur nje ven i punës lirohet pa planifikim pra kur vdes dikush kur shkon dikush jashtë vendit ,kurr merr dikush pushim pa pagës sepse ne rastet tjera drejtorat ose menagjeat e shkollave e kane obligim me ba raport ma herte mi nis procedurat na e këna obligim me q uni kuadër qe i plotëson kriteret me e zavensu qat mësimdhënës nuk e di a eshte zoja Muhadri a eshte gruaja e atij apo e këtij apo kush do qofte tjetër pe rate gja e këna përgjegjës in Drejtoria e Arsimit e qon kanë të don pra qe i plotëson kriteret per me ba zëvendësimin ja ka leju udhëzimi administrativ i ministrisë se Arsimit ndrrone atje na e respektojmë e bëjmë qysh thotë ajo,ke tjetër për poena e keni ne faqe zyrtare dalin poenat e atyne qe e kalojnë ose edhe atyne qe se kalojnë nëse nuk po gaboju muhamet une e di qe janë te obligum me i qit edhe poenat besoj gabimi teknik te bekimi po nuk po besoj ti i ke pa veq emrat po si ke kqyr poenat,pra edhe poenat i qesum per qdo konkurs pra sa i përket me marr pjese ju ne intervista nuk keni drejte dhe nuk do te merrni pjese asniher qdo OJQ qe oshte e regjistru me e kome thirr publikishte me ardhe mi vezhgu intervistat qofte me shkrim qofte me goje dhe qofte ato qe bahen ne nivel qendror pra OJQ institucionet tjera përgjegjës jo asambleistat as te opozitës as te pozitës as kryetari i komunës as zyrtart tjerë buk kane drejte me kane vezhgu te intervistimit te askujte se ti kur merr pjes ose une mundet me na padit kandidati qe ka ndiku qe une mos me kan i mire ne interviste une jom trem prej tina edhe na qon dyve per vitra,faleminderit

Hamit Haxhiu-po lidhna edhe unë me rastin e fundit me Egzonen vendimi qe është shpall i Drejtorisë për Arsim me 14.01.2022 dmth qe është i shpallur konkursi me 16.12.2021 nuk kame pa konkurs për disa kandidat qe potencoj edhe Egzona dmth 3 konkura janë te datës 16.12.2022 dy për mësimdhënës edhe një për tekniko shërbyes.

Drejtori i Arsimit- Muhame4t Gjoka- ju i përmendet dy konkurse, proceduralisht nje konkurs shkon ne rishpallje nëse nuk kane qene tre kandidatw qw i plotesojnw kriteret ne

fazën e parë dhe nëse nuk janë tre kandidatë në fazën e dytë merren profilet e përafërta dhe vazhdon procedura tutje .

Hamit Haxhiu, pse në konkurs kërkohen mësimdhënës të kësaj larmie ndërsa në vendim që ju e keni shpallë me 14 janë të pranuar disa mësimdhënës, ndërsa konkursi dhe rishpallja e konkursit nuk figuron drejtimi për këta mësimdhënës.

Drejtori i Arsimit- Muhamet Gjoka, nëse e keni fjalën për shkollën profesionale, e kemi pas një konkurs ku janë kerku dy mësimdhënës të profilit ekonomi të lendeve ekonomike, saktësisht nuk po e di datën çka është kërkua mund të kërkohen disa profile ose disa mësimdhënës edhe në shkollë të ndryshme ndërsa nëse gjatë procedurës nuk janë plotësuar kriteret për më vazhdu tutje atëherë njeri prej atyre konkurseve njeri prej atyre profileve shkone në rishpallje edhe njoftimi ka qenë në bazë të konkursit të datës 16.12.2021 sigurishtë është fjala për punëtorët tekniko-shërbyes në Komoran

Hamit Haxhiu, për rastin e mësimdhënësve të ekonomisë p.sh kur ti e ke shpall vendimin ju si drejtori me: 14.01.2022 dmth ju jeni bazu në bazë të konkursit të dt 16.12.2021 a është kështu shkollë mesme profesionale nuk ka konkurs

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, z. Haxhiu je profesor bane kërkesën zyrtarisht ,bane kërkesën në qasje publike të kthejna përgjigje me shkrim edhe në mbledhjen tjetër ju tregojmë për çka o fjala kur na thirrni në interpelancë i shtoni pyetjet edhe në përgjigje.

Pasi nuk pati diskutime të tjera mbledhja përfundoi në ora 15: 45 min .

Procesmbajtëse:

Liridona Fejza-Ajazi

Erlona Gashi



Kryesuesi i Kuvendi

Milaim Hajdari



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E GLLOGOCIT
ZYRA E KRYETARIT

Nr: 01.400-5840

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d i Ligjit nr 03/L - 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 10 paragrafi 2 dhe 5 i Ligjit për Mbeturina nr. 04/L-060, Vendimin e Kuvendit Komunal nr.12/501-13817 të datës 16.03.2016, që është miratuar Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave për vitet 2016 – 2020, Kuvendi i Komunës së Glogocit, në mbledhjen e mbajtur më _____, miraton këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për vazhdimin e vlefshmërisë së Planit Komunal të Menaxhimit të Mbeturinave për vitin 2022

- I.** Me këtë Propozim Vendim behet vazhdimi i vlefshmërisë së Planit Komunal të Mbeturinave sipas vendimit Komunal nr.12/501-13817 të datës 13.03.2016, deri me 31.12.2022.
- II.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjencë.
- III.** Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës dhe publikimit në gjuhët zyrtare në Web-faqen e Komunës

Kryetari
Ramiz Lladrovci



ARSYETIM

Plani Komunal i Menaxhimit të Mbeturinave (PKMM) i Komunës së Gllogocit është dokument i hartuar në bazë të Strategjisë për Menaxhimin e Mbeturinave të Republikës së Kosovës dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Mbeturinave në Republikën e Kosovës.

Objektivat dhe aktivitetet vjetore të planifikuara dhe realizuara në këtë plan raportohen në AMMK (Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës) dhe në MAPL, dhe janë mjaft të rëndësishme për Grantin “Mjedisi i Pastër” dhe atë të “Përformancës komunale”, të cilat vlerësojnë dhe shpërblejnë të arriturat e komunave në fushën e menaxhimit të mbeturinave, ku komuna nga këto grande vetëm në vitin e kaluar ka fituar mbi 1 milion euro.

Bazuar në planin aktual të menaxhimit të mbeturinave gjatë vitit kalendarik 2021 janë realizuar aktivitete lidhur me përmbushjen e objektivave të planifikuara, por edhe gjatë këtij viti objektivat në planin aktual janë të rëndësishme që të realizohen përmes aktiviteteve, andaj kërkohet që ky plan të jetë i vlefshëm për raportim edhe për vitin kalendarik 2022, deri sa të bëhet hartimi i Planit të ri.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
ZYRA E KRYETARIT

Nr. 01-360/01-5972 dt. 08.02 2022



Në vështrim të nenit 14.2 dhe 58 par.1 pika h të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 3 pika 1.1.neni 4 pika 1.1.neni 7 pika 1, neni 12 pika 1 dhe 2, si dhe nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-164 Për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe Udhëzimet Administrative, kërkesës me Nr. 06-070/01-1722, të dt. 13.01.2022, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës të miraton këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shfuqizimin e pikës 13 të nenit 1 të Vendimit Nr. 12-360-68569, të dt. 29.11.2019 të Kuvendit Komunal të Drenasit

Neni 1

1. Shfuqizohet pika 13 e nenit 1 të Vendimit të Kuvendit Komunal me Nr. protokoli 12-360-68569, të dt. 29.11.2019, për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të *Banesës me Nr. 13, Kati II-të*, Blloku I në Drenasin III, për z. Muhamet Berbatovci.

Neni 2

Me këtë Propozim -Vendim do të njoftohen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale, Zyra e Kryetarit dhe një mbetet për evidencë.

Neni 3

Ky Propozim Vendim hynë në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës, dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja.



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

A r s y e t i m

Më Ligjin Nr.03/L-164 Për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe Udhëzimet Administrative, të dala nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si dhe Programin Komunal Tre Vjeçar për Banim Social 2019-2021, rregullohet çështja e Banimit të Përkohshëm Social, në mënyrë që tu mundësohet zgjidhja e nevojave të banimit familjeve të caktuara të cilat nuk kanë forcë ekonomike ta zgjidhin këtë problem. Rrjedhimisht me Vendim Nr. 12-360-68569, dt. 29.11.2019 të K.K. Drenas, janë caktuar shfrytëzuesit e Banimit të Përkohshëm Social në periudhën kohore të caktuar.

Me kërkesën Nr. 06-070/01-1722, të dt. 13.01.2022 të ushtruar nga z. Muhamet Berbatovci është kërkuar që me vetëdëshirë të lirojë Banesën me Nr. 13, Kati II-të në Bllokun I në Drenasin III, përkatësisht të bëjë dorëzimin e çelësit të kësaj banese, si shfrytëzues i banesës së lartëshënuar për shkak se e ka zgjidhur çështjen e banimit.

Rrjedhimisht me paraqitjen e kësaj kërkesë Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale i rekomandon kryetarit që të aprovohet kërkesa e palës, përmes propozimvendimit në Kuvendin Komunal duke qenë se i njehti me vetëdëshirë ka kërkuar që banesën e lartëcekur ta lirojë, pasi që tanimë e ka të zgjidhur çështjen e banimit, përkatësisht të zhvilloj procedurat e parapara me legjislacionin në fuqi, përkatësisht në dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe Udhëzimet Administrative, duke propozuar që të bëhet shfuqizimi i pikës 13 të nenit 1 të Vendimit të Kuvendit Komunal me Nr. protokoli 12-360-68569, të dt. 29.11.2019, për lejimin e vazhdimit të kontratave me qira joprofitabile mbi dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të banesave sociale në Bllokun e Banimit të Përkohshëm Social I dhe II në Drenasin III.

Ky propozimvendim vie në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, për të arritur stabilitet social dhe mirëqenje njerëzore duke hapur mundësi për familje në nevojë si qellim themelor i Programit të Banimit të Përkohshëm Social.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Nr 01-020/04-5969 dt. 08.02.2022

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gaz.Zyrt.e Republikës së Kosovës"), nenit 34.6 nënpika f të Statutit të Komunës së Glllogocit të aprovuar në vitin 2008, Programit Komunal tre Vjeçar për Banim, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2022 të aprovoi këtë:

P R O P O Z I M V E N D I M

Për formimin e komisionit për çështjet e banimit të përkohshëm social

Neni 1

Më këtë Propozim Vendim formohet Komisioni për çështjet e banimit të përkohshëm social në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve, të cilin Komision e përbejnë tre (3) anëtar nga Ekzekutivi i Komunës të cilët i propozon Kryetari i Komunës, tre (3) anëtar nga Kuvendi i Komunës nga subjektet e ndryshme të përfaqësuar në Kuvend, dhe një (1) anëtar nga shoqëria civile i propozuar nga Kryetari i Komunës si vijon:

1. _____ - anëtar nga kuvendi
2. _____ - anëtar nga kuvendi
3. _____ - anëtar nga kuvendi
4. _____ - anëtar nga ekzekutivi
5. _____ - anëtar nga ekzekutivi
6. _____ - anëtar nga ekzekutivi dhe
7. _____ - përfaqësues nga shoqëria civile

Neni 2

Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e gjendjes ekonomike të familjeve me qellim të vazhdimit ose ndërprerjes së kontratave, përpilimin e listës përfituese, largimin e familjeve që nuk plotësojnë kriteret dhe çështje tjera të banimit të përkohshëm social.

Neni 3

Komisioni për çështjen e banimit të përkohshëm social në Komunën e Drenasit, punën e tyre duhet ta kryejnë me profesionalizëm të lartë dhe përkushtim.

Neni 4

Ky komision ka për obligim që për punën e tij t'i raportoj Kuvendit të Komunës së Drenasit çdo 6 muaj.

Neni 5

Mandati i këtij komisioni është 3 vjeçar, në përputhje me Programin Komunal për Banim.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci
Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Banimi dhe sigurimi i çështjes së banimit të qytetarëve është obligim i komunës. Pra, Komuna merret me sigurimin e banimit për ata qytetarë të cilët nuk kanë mundësi për të siguruar kulm mbi kokë për vete dhe familjet e tyre. Banimi është çështje vendimtare për një stabilitet social, shëndet të mire dhe zhvillim kualitativ të mirëqenies sociale njerëzore. Vlen të theksohet se e drejta e banimit është njëra ndër të drejtat elementare të njeriut që garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Konventën Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut si dhe me Kartën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Me miratimin e Ligjit për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, Nr. 03/L-164, ofrohet një kornizë më e avancuar për autoritetet vendimmarrëse lokale, duke ofruar banim të qëndrueshëm për popullatën në territorin e komunave të Republikës së Kosovës. Edhe Komuna e Drenasit në programet e saj zhvillimore ka për qellim përmirësimin e banimit social për qytetarët e saj, duke mundësuar kushte për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm për ato familje të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit dhe me forca vetanake e kanë vështirë të e bëjnë një gjë të tillë.

Përmes krijimit të këtij komisioni synojmë plotësimin e obligimeve ligjore rreth banimit të përkohshëm social, e që puna e tij ndërlidhet ngushtë me përmirësimin e gjendjes ekonomiko-sociale të familjeve që akoma e kanë të pazgjidhur çështjen e banimit.

Duke u nisur nga të gjitha ato që u thanë me lart, do të formohet ky komision.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr 020/64-6024 dt. 08/02 2022

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), Shkresës Nr.020-84/12, të datës 08.02.2022 të MAPL-së, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë ____ 02.2022, të aprovoi këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shfuqizimin e vendimit Nr.12-462/01-4122, të datës 26.01.2022

Neni 1

Më këtë Propozim Vendim i propozohet Kuvendit të Komunës shfuqizimi i vendimit **Nr.12-462/01-4122**, të datës 26.01.2022, për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Neni 2

Shfuqizimi i vendimit Nr.12-462/01-4122, të datës 26.01.2022, bëhet sipas rekomandimeve të MAPL-së, të shkresës Nr.020-84/12, të datës 08.02.2022.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.


Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Kuvendi i Komunës së Drenasit me datë 26.01.2022 ka aprovuar vendimin Nr.12-462/01-4122 për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, mirëpo pas vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal sipas shkresës Nr.020-84/12, të datës 08.02.2022 është kërkuar nga ana e Komunës së Drenasit që për secilin vendim paraprak të Kuvendit të Komunës të formohet komision vlerësues, andaj Komuna e Drenasit në përputhje me

rekomandimet e MAPL-së, do të formoje komisionin vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, pas marrjes së miratimit paraprakë nga Kuvendi për pronat të cilat do të ipen në shfrytëzim në vitin 2022.

Me respekt!